



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 1283, datë 19.08.10%

Nr. 10124, datë 8.8.19

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

1. QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (referuar si “QKB”), person juridik publik, krijuar me ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me seli në Tiranë, Bulevardi “Zhan D’ark”, përfaqësuar nga Drejtor i Përgjithshëm, Znj. Pranvera FAGU (BEHUSHI),

DHE

2. DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE (referuar si “DPT”), me seli në adresën, rruga “Gjin Bue Shpata”, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtor i Përgjithshëm, Znj. Delina IBRAHIMAJ,

(këtej e tutje veçmas referuar si “pala” dhe së bashku referuar si “palët”).

Baza Ligjore:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të nenit 69, të Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, dhe të nenit 24, 40, 45 e 61 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, palët e mësipërme sipas kushteve vijuese lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi me qëllim transmetimin e të dhënave të Regjistrat Tregtar, mbi regjistrimin dhe ndryshimet në regjistrim / çregjistrim të subjekteve, si dhe kryerjen e veprimeve të tjera në interes të përbashkët të dyja palëve, për një administrimin më të mirë të gjithë aktivitetit të regjistrimit të subjekteve.

NENI 1

RËNDËSIA

- 1.1 QKB në zbatim të Ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe të Ligjit nr. 9723, datë 03/05/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, është institucioni përgjegjës për regjistrimin e subjekteve pranë regjistrat tregtar dhe të dhënave lidhur me to, si dhe për administrimin

- e Regjistrat Tregtar dhe të dhënavat e regjistruar pranë saj. Në kuadër të funksionimit të saj QKB, kryen regjistimet në regjistrin tregtar, lëshon çertifikata, ekstrakte të regjistimeve dhe kopje të vërtetuarat e akteve të depozituara, publikon të dhënat e regjistrat të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to, informon dhe kryen procedurat e regjistrimit dhe të licensimit të subjekteve.
- 1.2 DPT në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar është autoriteti tatimor qëndror i vetëm në Republikën e Shqipërisë që zbaton dhe administron tatimet kombëtare në përgjithësi, si dhe institucioni që administron Sistemin Informatik Tatimor në veçanti. DPT nëpërmjet menaxhimit të Sistemit Tatimor synon pasqyrimin e aktivitetit tregtar, të të dhënavat personale dhe detyrimeve tatimore të tatimpaguesit në kohë reale.
- 1.3 Bashkëpunimi institucional midis palëve është i domosdoshëm dhe i rëndësishëm pasi ndihmon në zbatimin sa më korrekt të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi korrekt i ligjit, koordinimin e veprimeve për qëllimin e përbashkët, si dhe respektimin e parimit bazë të administratës tatimore, që konsiston, në mbledhjen dhe administrimin e tatimeve kombëtare duke zbatuar në mënyrë të njëjtë dhe efektive legjislacionin tatimor ndaj të gjithë tatimpaguesve.

NENI 2

PËRKUFIZIMI I TERMAVE

- 2.1 Termat e përdorur në ketë Marrëveshje Bashkëpunimi, kanë kuptimet vijuese:

- “QKB”, nënkuption Qendra Kombëtare e Biznesit.
- “DPT”, nënkuption Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
- “Administrata Tatimore” në kuptim të kësaj marrëveshje nënkuption DPT dhe/ose DRT (drejtoritë rajonale tatimore të varësi të saj).
- “Subjekt”, në kuptim të kësaj marrëveshje, janë subjektet tregtare dhe subjektet e tjera të cilat pa pasur cilësinë e tregtarit, që kanë detyrimin e regjistrimit në regjistrin tregtar dhe që detyrohen nga ligji të deklarojnë dhe/apo të paguajnë tatime.
- “Regjistrim” është regjistrimi filletar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.
- “Shtojcë”, nënkuption Protokollin e Shkëmbimit Elektronik, që është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

NENI 3

OBJEKTI I MARRËVESHJES

- 3.1 Kjo Marrëveshje bashkëpunimi parashtron procedurat që do të udhëheqin procesin e transmetimit të të dhënavat e aktivitetit të Regjistrat Tregtar, në lidhje me regjistimet që kryejnë subjektet si dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet QKB dhe DPT, në pajtim me:

- a) dispozitat e Ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe të Ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, dhe të akteve nënligjore të tjera në zbatim të këtyre ligjeve,
- b) dispozitat e ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të akteve të tjera në zbatim të këtij ligji.

- 3.2. Të përcaktojë rregulla dhe veprime teknike për marrjen, dërgimin dhe shkëmbimin e të dhënave si dhe informacioneve midis dy institucioneve. Kjo realizohet nëpërmjet hapave të detajuara në Protokollin e Shkëmbimit Elektronik i cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 4

MENYRA E REALIZIMIT

Me anë të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi QKB dhe DPT, bien dakord përsa vijon:

- 4.1 Transmetimi i të dhënave nga QKB tek DPT, administrimi i tyre dhe konkretizimi i të gjithë aktivitetit të regjistrimit të subjekteve, do të kryhet nga QKB nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:

- a. Çdo aplikim për regjistrimin e një biznesi të ri duhet të miratohet nga nëpunësi i autorizuar i QKB-së, i cili do të sigurohet se aplikimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, edhe sipas kërkesave për regjistrimin fiskal.
- b. Një person fizik me të njëjtin numër të identifikimit personal regjistrohet vetëm një herë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NIPT/NUIS të ri nga Qendra Kombëtare e Biznesit, vetëm pas çregjistrimit të NIPT-it/NUIS-it ekzistues.
- c. QKB garanton që një subjekt i cili regjistrohet si subjekt i Tatim Fitimit (Biznes i madh) nuk mund të regjistrohet njëkohësisht edhe si tatimpagues i Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin (si Biznes i vogël) dhe anasjelltas.
- d. Me miratimin e një aplikimi për regjistrimin e një biznesi të ri, QKB do të gjenerojë një Numër Unik Identifikimi të subjektit (NUIS/NIPT) i cili i lëshohet subjektit të regjistruar në regjistrin tregtar. Me gjenerimin e NUIS/NIPT-it, QKB duhet t'i sigurojë DPT në mënyrë elektronike të dhënat e duhura për regjistrimin e subjektit të saporegjistruar. Të dhënat që dërgohen nga QKB pëershkuhen në shtojcën "Protokolli i Komunikimit Elektronik" ndërmjet DPT dhe QKB. Ky numër "NUIS" është pjesë e të dhënave që do të transmetohen në DPT. Duke qenë se në DPT do të vazhdojnë të regjistrohen dhe marrin NUIS/NIPT tatimpagues jobiznese, QKB dhe DPT bien dakord të përdoren për gjenerimin e NUIS-eve intervalet sipas shtojcës: "Ndarja e intervaleve për NUIS-et që do të përdoren nga QKB dhe DPT".
- e. Për çdo aplikim për regjistime të tjera (ndryshime) të një biznesi të regjistruar, pas miratimit te tij, QKB-ja kryen transmetimin e të dhënave të ndryshuara të regjistrimit pranë DPT, sipas rregullave të Protokollit të Komunikimit Elektronik, bashkëlidhur kësaj Marrëveshje.
- f. Nëse konstatohen gabime gjatë transmetimit të të dhënave, QKB përcakton dhe parandalon shkakun e gabimit dhe rregullon menjëherë gabimet e kryera, duke njofuar DPT për këtë rregullim dhe duke dërguar në formë elektronike të gjitha të dhënat dhe informacionin e rregulluar. Procedurat për rregullimin e gabimeve në të dhënat tashmë të dërguara nga QKB në DPT, janë pëershruar në pikën 4.3 të kësaj marrëveshjeje.
- g. Në të gjitha rastet kur QKB merr kërkesa për çregjistrim nga subjektet, do të njofojë elektronikisht DPT, për subjektet që kanë kërkuar të çregjistrohen. Kjo do të bëhet elektronikisht, sipas rregullave të Protokollit Elektronik të Komunikimit, bashkëlidhur kësaj Marrëveshje. DPT i krijon mundësi QKB që në çdo moment të verifikojë elektronikisht situatën e Subjektit /Tatimpaguesit sipas sistemit

tatimor në lidhje me detyrim et e papaguara dhe deklaratat e padorëzuara deri në datën e aplikimit për çregjistrim.

QKB nuk do të çregjistrojë subjektin/tatimpaguesin nga Regjistri Tregtar, në rastet:

- i. Kur ka detyrime tatimore të papaguara, dhe,
 - ii. Kur tatimpaguesi ka deklarata tatimore të padorëzuara.
- h. Në rastin kur subjektet riaplikojnë për çregjistrim në QKB dhe kjo e fundit hap një çështje të re, atëherë ky veprim dërgohet drejt DPT si informacion për t'u pasqyruar në Sistemin Tatimor. Pavarësisht këtyre rasteve DPT nuk ndryshon datën e Aplikimit të parë për çregjistrim që ka bërë subjekti në QKB. Edhe në këtë rast DPT i krijon mundësi QKB që në çdo moment të verifikojë elektronikisht situatën e Subjektit/Tatimpaguesit sipas sistemit tatimor në lidhje me detyrimet e papaguara dhe deklaratat e padorëzuara deri në këtë datë.
- i. Pas çregjistrimit të subjektit /tatimpaguesit, QKB dërgon menjëherë njoftimin e çregjistrimit në DPT, në mënyrë elektronike, me qëllim që Administrata Tatimore të vazhdojë procesin e çregjistrimit përfundimtar nga Regjistri Tatimor. Ky njoftim do të bëhet elektronikisht në DPT, sipas rregullave të Protokollit të Komunikimit Elektronik, bashkëlidhur kësaj Marrëveshje.
 - j. QKB për çdo rast që subjektet kërkojnë pezullimin e aktivitetit pranë saj, bën paraprakisht verifikimin e situatës tatimore lidhur me detyrimet e papaguara të subjektit/tatimpaguesit në Sistemin tatimor. Nëse subjekti/tatimpaguesi rezulton me detyrime tatimore QKB nuk bën miratimin e pezullimit. Kur nuk rezultojnë detyrime tatimore në llogarinë e subjektit/tatimpaguesit, QKB bën miratimin e pezullimit dhe dërgon në DPT informacion mbi datën e miratimit të pezullimit dhe afatin e pezullimit rast pas rasti. Kur ky afat është mbi 12 muaj të njëpasnjëshëm apo pa afat, statusi i tatimpaguesit në sistemin tatimor ndryshon automatikisht nga "aktiv" në "pasiv". Rregullat e këtij procesi janë të përcaktuara në Protokolin e Komunikimit Elektronik, shtojcë e kësaj marrëveshje.
 - k. Në rastin kur subjekti /tatimpaguesi, nga i pezulluar në QKB aktivizon aktivitetin e tij, QKB dërgon këtë regjistrim në mënyrë elektronike në DPT me qëllim kalimin në Sistemin Tatimor nga statusi "pasiv" në statusin "aktiv", sipas rregullave të Protokollit të Komunikimit Elektronik, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.
 - l. QKB dërgon elektronikisht në DPT njoftimin e hapjes së procedurave të likuidimit të shoqërive ku të jetë përcaktuar data e hapjes së procedurave të likuidimit, likuidatori etj. Kjo e dhënë do të pasqyrohet përveç në sistemin e QKB-së edhe në të dhënët e tatimpaguesit në sistemin Tatimor. Veprimet dhe procedurat janë parashikuar në Protokolin e Komunikimit Elektronik midis dy institucioneve.
 - m. QKB dërgon elektronikisht në DPT çdo vendim të miratuar për riorganizimin e shoqërive. Sqarimet përrugën dhe hapat që kryhen nga QKB në rastet e riorganizimit të shoqërive janë dhënë në Protokolin e Komunikimit Elektronik. QKB për shoqëritë që nuk do të ekzistojnë pas procesit të riorganizimit (çregjistrim pa likuidim) do të njoftojë DPT që të ndjekë procedurat e çregjistrimit të tyre nga regjistri i tatimpaguesve. Për shoqëritë që lindin si të reja nga procesi i riorganizimit, ky informacion do të dërgohet nga QKB në DPT si regjistrim i Ri. Këto njoftime do të dërgohen elektronikisht në DPT, sipas rregullave të Protokollin e Komunikimit Elektronik.

- n. Në çdo rast të ndryshimeve të legjislacionit tatumor që prek Seksionin “D”, që lidhet më DPT, me qëllim pasqyrimin real të situatës tatumore të subjektit, QKB azhornon/shtron, në Formularët e “Aplikimit për regjistrim apo Ndryshim të të dhënave”, rubrika të veçanta në Formular, tek të dhënat e detyrueshme.
- 4.2. Përpunimi i të dhënave nga DPT, bashkëpunimi me QKB-në, administrimi i tyre dhe konkretizimi i të gjithë aktivitetit të regjistrimit në Regjistrin Tregtar, do të kryhet nga DPT nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:
- a) Kur, për ndonjë arsy, sistemit elektronik në DPT i rezultojnë gabime në ngarkimin e të dhënave të transmetuara nga QKB, atëherë DPT duhet të informojë elektronikisht QKB menjëherë nga identifikimi i problemit, përsa i përket gabimit në fjalë duke dhënë dhe shkakun e gabimit. Me gabim do të *përfshihen të gjitha të dhënat të regjistruara si pasojë e deklarimit gabim nga subjekti ose të cilat janë korigjuar nga QKB*. Më tej, QKB është përgjegjëse për të ndreçur shkakun e gabimit, duke njoftuar DPT për këtë ndreçje dhe duke i ridërguar në formë elektronike të gjitha të dhënat me informacionin e rregulluar për biznesin e regjistruar. Mënyra se si do të kryhet ky komunikim elektronik është përcaktuar në pikën 4.3 të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi.
- b) Sistemi elektronik i DPT sinjalizon për gabimin në regjistrimin e të dhënave dhe informacionit të transmetuar nga QKB, kur:
- nuk është përcaktuar qartë apo është përcaktuar gabim rrethi ku është regjistruar subjekti,
 - qytet/fshati i adresës kryesore apo sekondare është bosh,
 - kur përqindja e kuotave/aksioneve është mbi 100%,
 - Kur është vepruar mbi seriale të çertifikatave të myllura në tatime,
 - Kur ka ndryshuar rrethi, selia apo adresat dytësore dhe nuk ka ndryshuar numri serial i çertifikatës/ve,
 - Forma ligjore është formë e paparashikuar më parë në protokollin e komunikimit,
 - Pronësia është formë e re e paparashikuar më parë në protokollin e komunikimit,
 - Kur janë përcaktuar gabim llojet e tatimeve të cilat do të paguajë subjekti etj., dhe subjekti është regjistruar dhe si B.Vogël për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin edhe si B. Madh për Tatim Fitimi,
 - Cdo rast tjetër që bie ndesh me rregullat e Protokollit të Komunikimit Elektronik, bashkëlidhur kësaj Marrëveshje dhe nuk është parashikuar shprehimisht më sipër.
- c) DPT me kërkesë të QKB apo kur konstaton se nga ana e saj nuk janë transferuar në QKB të dhënat për subjekte të veçanta, i dërgon asaj informacionin zyrtarisht për këto subjekte.
- d) DPT me kërkesë të QKB-së jep informacion shtesë apo të dhëna plotësuese për çdo subjekt që kërkohet nga ana e saj.
- e) DPT dhe QKB për çdo veprim të kryer mbi regjistrimet e reja dhe ndryshimet vendosin një procedurë monitorimi dhe rakordimi për një periudhë të caktuar kohe.
- f) Të gjitha rastet e përmendura në pikat a, b, c, d, më sipër do të zgjidhen në një periudhë kohore jo më të gjatë se 7 ditë kalendarike, nga të dyja palët ne rastet kur problemet jane midis dy institucioneve.
- 4.3. Rregullimi i gabimeve në regjistrim apo në ndryshimet e të dhënave të regjistrimit do të kryhet si më poshtë vijon:
- a) Për ndryshimet dhe zhvillimet që kryhen në sistemin e QKB dhe që kanë reflektim në të dhënat e dërguara në DPT, përpara implementimit të tyre, QKB njofton zyrtarisht DPT, në mënyrë që dhe DPT të pasqyrojë këto ndryshime në Sistemin e saj.

- b) Për procedurën e zgjidhjes së problematikave, në përcjelljen apo komunikimin elektronik QKB-DPT, DPT do dërgojë elektronikisht drejt QKB përshkrimin e gabimeve analitike që ajo konstaton. QKB merr masa për zgjidhjen e problemeve dhe i dërgon DPT, të dhënat e rregulluara.
- c) Për zgjidhjen e problemeve teknike të natyrave të ndryshme QKB dhe DPT do të ngrajnë një Komitet Teknik. Ky Komitet do të përbëhet nga 6 persona, (3 QKB dhe 3 DPT) dhe do të udhëhiqet nga dy bashkëkryetarë, (një nga secila palë) e do të mblidhet sipas nevojave dhe kërkesave reciproke për trajtimin e problemeve. Secila palë propozon zgjidhjen konkrete dhe informon eprorët përkatës deri në marrjen e një vendimi të përbashkët.

Anëtarët e Komitetit Teknik të përbashkët do të caktohen me Urdhër të Titullarëve të dy institucioneve..

-
- 4.4. Në lidhje me përditësimin e kodit të veprimtarisë ekonomike NVE (NACE) të subjektit/tatimpaguesit, ~~kur administrata Tatimore (Drejtori i Rajonale Tatimore)~~, konstaton se aktiviteti që zhvillohet nga ana e tij, nuk përputhet me kodin e veprimtarisë ekonomike NVE (NACE) përkatës, ajo saktëson dhe njofton QKB për t'a pasqyruar në sistemin e saj.
 - 4.5. DPT i krijon mundësi QKB që në çdo moment të verifikojë elektronikisht çdo subjekt/Tatimpagues nëse ka detyrimin për të dorëzuar pasqyra financiare (bilancin Vjetor) pranë saj. DPT, do të informojë QKB në formë elektronike për ndryshimet mbi detyrimin e subjektit/tatimpaguesit, për të dorëzuar pasqyrat financiare, sipas rregullave të përcaktuara në Protokollin e Komunikimit Elektronik.
 - 4.6. Administrata Tatimore do të ketë akses në të gjithë dokumentacionin e administruar nga QKB për të gjitha subjektit/tatimpaguesit e regjistruar në Regjistrin Tregtar. Gjithashtu, palët e kësaj marrëveshje marrin përsipër të vënë në dispozicion të palës kërkuese vetëm dokumentacionin e kërkuar të cilin nuk kanë mundur ta akesojnë në rrugë elektronike, në respektim të legjislacionit në fuqi.

NENI 5 PIKAT E KONTAKTIT

- 5.1 Secila prej palëve do të caktojë një person kontakti përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëveshjes me qëllim koordinimin e veprimeve për realizimin e saj. Ky person kontakti është bashkëkryetari i grupit të punës të ngritur sipas përcaktimeve të bëra në pikën 4.3 të kësaj marrëveshjeje.

NENI 6 NDASHMËRIA E MARRËVESHJES

- 6.1 Nëse ndonjë parashikim në këtë Marrëveshje është i pavlefshëm, ose i pazbatueshëm, apo ndryshon në të ardhmen me akte normative apo dispozita ligjore, ky parashikim do të ndahet, dhe të gjitha parashikimet e kësaj Marrëveshje do të mbeten plotësisht në fuqi. Asnjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje nuk është i varur nga ndonjë tjetër parashikim përvçese në rast se është shprehur në këtë Marrëveshje.

NENI 7 ZBATIMI I MARRËVESHJES

- 7.1 Zbatimi i plotë i marrëveshjes për pjesën e bashkëveprimit elektronik, do të bëhet funksional pas plotësimit të kërkesave reciproke të paraqitura për zhvillim nga dy institucionet, në sistemet elektronike respektive.

- 7.2 Deri në implementimin e të gjitha kërkesave për zhvillim mbetet në fuqi procedura aktuale e komunikimit.

NENI 8
HYRJA NE FUQI

- 8.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin nga të dyja palët e saj.
- 8.2 Kjo marrëveshje do të lidhet për një periudhe të pacaktuar kohe.
- 8.3 Palët do ta rishikojnë dhe përmirësojnë këtë Marrëveshje, sa herë që ka arsyet e nevojshme nga secila prej palëve, me qëllim pasqyrimin në të, të ndryshimeve të nevojshme për shkëmbimin e informacionit të të gjitha të dhënavë të regjistruara pranë regjistrat tregtar.
-
- 8.4 Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 12420/1 prot. të QKB, datë 07.09.2017 dhe nr. 19812 datë 22.08.2017 të DPT e lidhur midis dy institucioneve, shfuqizohet.
- 8.5 Kjo Marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Nënshkruar në Tiranë, sot, më datë _____. _____.2019.

PËR



PËR

DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

QENDRËN KOMBËTARE TE BIZNESIT

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Delina IBRAHIMAJ



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Pranvera FAGU (BEHUSHI)

